



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 8, datë 14.01.2021

PËR
VLERËSIMIN E PËRSHPEJTUAR ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...},
PËR VITIN 2019

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 97, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit të përshpejtuar etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2019”, i hartuar nga relatore znj. Brunilda Kadi,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit të përshpejtuar etik dhe profesional i gjyqtares {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

EKSTRAKT

**RAPORT I VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL
TË GJYQTARIT {...}**

(i azhonuar me vendimin nr. 31 datë 25.01.2021)

**ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI
PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1-A Njohuritë ligjore.

1-A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit konstatohet se në të gjitha vendimet e dhëna, gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në përcaktimin e fakteve të çështjes penale objekt shqyrtimi. Në vendimet e saj, fillimisht gjyqtarja ndalet dhe përshkruan rrethanat dhe faktet e çështjes, më pas përcakton natyrën e çështjes dhe fazën procedurale në të cilën është çështja objekt gjykimi, citon dispozitat ligjore në lidhje me ekzistencën e faktit penal, duke përfunduar me identifikimin dhe citimin e dispozitave procedurale, në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Gjyqtarja identifikon natyrën e faktit penal objekt gjykimi, shoqëruar me paraqitjen dhe analizën e provave mbi të cilat mbështet faktet. Në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit, gjyqtarja rimerr në vlerësim faktin penal, lidhur me kualifikimin ligjor të faktit, elementët e veprës penale

dhe rolin e secilit të pandehur. Evidentohet aftësia e gjyqtares për të përcaktuar dhe referuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në dispozitat e ligjit procedural dhe ligjit material penal.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim mbi secilin fakt.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

1-A-b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Në përputhje me rrethanat faktike dhe procedurale të çështjes, gjyqtarja interpreton normat ligjore duke i'u përgjigjur kërkesave të palëve në proces. Gjyqtarja, interpreton dispozitat materiale, në përputhje me rrethanat e faktit në lidhje me ekzistencën e faktit penal, fajësinë si dhe dispozitat materiale për kualifikimin ligjor të faktit penal për të pandehurin/pandehurit. Në arritjen e konkluzioneve në lidhje me cilësimin juridik të veprave penale që i atribuohen të pandehurit/pandehurve, i referohet jo vetëm praktikës së unifikuar të Gjykatës së Lartë, por edhe praktikës së konsoliduar nga gjykatat më të larta. Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, në çdo rast janë respektuar me korrektësi aspektet e parimit të procesit të rregullt ligjor. Gjyqtarja interpreton dhe analizon në mënyrë specifike rrethanat që ndikojnë në individualizimin e dënimit për të pandehurin/pandehurit.

Në vendimet përfundimtare evidentohet aftësia e gjyqtares për të përdorur dhe kur është rasti, analizuar jurisprudencën njësuere dhe unifikuese të Gjykatës së Lartë, me qëllim përcaktimin e kompetencës lëndore për shqyrtimin e çështjes, në lidhje me përcaktimin e “pasojës së rëndë” të ardhur nga kryerja e veprës penale, në lidhje me përgjegjësinë penale dhe konkurrimin e veprave penale të secilit të pandehur, në lidhje me kërkesën për të proceduar me gjykim të shkurtuar.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se gjyqtarja ka aftësi mbi mesataren për të interpretuar ligjin në funksion të zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Mbi mesataren”, duke u pikëzuar me 20 pikë.

I-B Arsyetimi ligjor

1-B-a Qartësia, konçiziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Vendimet e gjyqtares janë të organizuara sipas një strukture të qartë dhe të standardizuar. Pjesa hyrëse e të gjitha vendimeve përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohës së zhvillimit të gjykimit, të dhënat e plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, akuzën e plotë dhe nenet përkatëse të Kodit Penal, si dhe kërkimet e

palëve në mënyrë të përmbledhur. Pjesa përshkruese arsyetuese është në të gjitha vendimet e organizuar sipas një strukture të njëjtë, të standardizuar, organizuar nëndarje të cilat shoqërohen me tituj identifikues dhe të renditura sipas një linjë logjike me njëra tjetrën. Dispozitivi i vendimeve është i plotë, i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, duke përmbajtur në mënyrë të plotë të gjitha disponimet e gjykatës lidhur me fajësinë e të pandehurve, akuzën përkatëse, nenet respektive të Kodit Penal, llojin dhe masën e dënimit, bashkimin e dënimeve dhe uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar kur është aplikuar, kohën e fillimit të llogaritjes së tij, institucionin e vuajtjes së dënimit, disponimin për provat materiale, shpenzimet procedurale si dhe disponimin për ngarkimin e prokurorisë për ekzekutimin si dhe të drejtën e ankimit.

Në veprimet për drejtimin e seancave gjyqësore dhe vendimet përfundimtare përdoret gjuhë e thjeshtë, e qartë, e kuptueshme dhe e drejtpërdrejtë. Evidentohet respektim i rregullave gramatikore dhe të sintaksës, përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, fjalitë janë me gjatësi mesatare, të kuptueshme dhe të organizuara qartë dhe thjeshtë. Të gjitha vendimet janë të organizuara me paragrafë, të cilat kanë lidhje logjike me njëri tjetrin. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë konfuzion në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

I-B-b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Gjyqtarja i harton vendimet e saj me strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar, duke evidentuar qartë tri pjesët përbërëse të vendimit (*pjesa hyrëse, arsyetimi dhe pjesa urdhëruese*).

Në *pjesën hyrëse* të vendimit, gjenden të pasqyruara të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjykues, identitetin e palëve, akuzën si dhe kërkimet përfundimtare të palëve në proces. *Pjesa arsyetuese* e vendimit gjithashtu ndjek një strukturë të mirë përcaktuar e cila kryesisht është e ndarë në disa pjesë, në të cilën në mënyrë të detajuar analizohen, rrethanat e faktit, në të cilën gjyqtarja rendit veprimet hetimore të kryera nga ana e organit të akuzës, më pas pasqyron vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në seancë paraprake, për të vijuar më pas me kërkesat procedurale, që kanë rezultuar gjatë shqyrtimit të çështjes në themel, rrethanat e fakteve të çështjes të ndara veç nga provat, provat e marra gjatë gjykimit, pretendimet e palëve gjatë gjykimit, vlerësimi i gjykatës, në të cilën merr në analizë ligjin e zbatueshëm, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarës dhe konkluzionin e saj. Në *pjesën e dispozitivit* gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Përsa i takon dispozitivit të vendimit, gjyqtarja përdor teknikën e listimit të disponimeve pa i numërtuar ato, që vështirëson referencat në rastin kur vendimi ka disa disponime.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

I-B-c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Në vendimet gjyqësore të vëzhguara konstatohet se arsyetimi i vendimeve përfundimtare nga ana e gjyqtares, përgjithësisht ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material penal. Në secilin vendim, gjyqtarja analizon ekzistencën e faktit penal dhe përgjegjshmërinë penale të autorëve të veprës penale duke renditur faktet e provuara në mënyrë specifike. Gjyqtarja në vendim bën analizë të cilësimit juridik të veprës penale, në përputhje dhe me rrethanat e faktit penal. Gjithashtu, gjyqtarja analizon shkaqet dhe pretendimet e palëve, duke analizuar dispozitat përkatëse materiale në përputhje me rrethanat e faktit. Interpreton dhe analizon në mënyrë specifike rrethanat që ndikojnë në individualizimin e dënimit. Dispozitat ligjore në zbatim të çështjeve konkrete, jo vetëm citohen nga gjyqtarja por edhe interpretohen në raport me faktet e çështjes, si dhe duke mbajtur në vëmendje edhe konkluzionet e arritura nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Niveli i arsyetimit të vendimeve është gjithë përfshirës, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve.

Në përgjithësi, arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik, por i kushtohet peshë specifike parashtrimit të faktit, provave dhe analizës së tyre në raport me veprat penale dhe rolin e të pandehurve në kryerjen e tyre, duke referuar normën ligjore (procedurale ose materiale) që gjen zbatim dhe përfaqshjen e saj me faktin e provuar, por jo gjithmonë ndalet në analizën e koncepteve, instituteve dhe dispozitave ligjore mes tyre, apo në mënyrën se si ato gjejnë ose jo zbatim në rastin konkret.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Mbi mesatar”, duke u pikëzuar me 20 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
90	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2. A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ka gjykuar 7.36 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ka gjykuar 10.3 % të çështjeve jashtë standardeve minimale kohore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, për shumicën e kategorive të çështjeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore është 96.9 %.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Mbi mesataren”, duke u pikëzuar me 8 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor nga ana e gjyqtares, është më e shkurtër se afati procedural, për shumicën e kategorive të çështjeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Mbi mesataren”, duke u pikëzuar me 12 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh është 10.27, por nga ana e gjyqtares janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar; a) analizës së çështjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, nga të cilat evidentohet se; Gjykata në të gjitha çështjet e përzgjedhura me short e ka vënë në lëvizje dosjen po atë ditë që caktohet me cilësinë e relatorit të çështjes ose një ditë më pas. Ka kryer veprimet procedurale të nevojshme për njoftimin në mënyrë efektive të të gjitha palëve ndërgjyqëse. Gjithashtu rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara në dosje si: vendimi për caktimin e seancës gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të arësyetuara për kthimin e akteve organit të akuzës për plotësimin e hetimeve, vendimi për vlerësimin e masës së sigurimit konform nenit 88 të K.Pr.Penale etj. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qënë i rregullt dhe gjykata rezulton që të jetë shprehur me urdhra dhe vendime të ndërmjetme për çdo kërkesë të palëve ndërgjyqëse në përputhje edhe me llojin e gjykimit (kërkesë në fazën e hetimeve paraprake, seancë paraprake apo gjykim themeli). Në përgjithësi konstatohet se seancat kanë filluar me vonesë, por nga ana e gjykatës është relatuar përgjithësisht vonesa dhe po kështu konstatohet se vonesa është shkaktuar për shkaqe të pavarura nga ana e gjykatës. Konstatohet gjithashtu se seancat gjyqësore janë të rregjistruara me sistemin audio, por ndërkohë është mbajtur edhe procesverbal në mënyrë të përmbledhur, dhe b) burimeve të tjera të vlerësimit, evidentohet se nga ana e gjyqtares janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se nga ana e gjyqtares renditja e akteve të dosjes gjyqësore është në mënyrë që e bën dosjen lehtësisht të shfrytëzueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet që dokumentacioni në dosje, është në përputhje me veprimet proceduriale të kryera, nuk ka mungesa dhe se është i duhuri.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm ¹

3.ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

¹ (i azhonuar me vendimin nr. 31 datë 25.01.2021)

3. A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cënim të etikës apo përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksionit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje, apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarës, gjatë ushtrimit të funksionit.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3. B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit si dhe **nuk** rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që çënojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.

3. C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** rezulton që gjyqtarja, të ketë përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit si dhe në përmbytjen e vendimeve të hartuara prej saj.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se nuk ka asnjë kërkesë të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues , vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A. a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent, me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve, apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, gjyqtarja në këtë tregues, vlerësohet në nivelin “Shumë i lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, prezumohet se ajo ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, prezumohet se ajo ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja gjatë vitit 2019, ka marrë pjesë në 7 (shtatë) aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës në rolin e lehtësueses, ekspertes dhe pjesëmarrëses, konvertuar në numër ditësh 19 ditë². Kohëzgjatje kjo që është brenda kufijve të parashikuar nga 5 deri në 40 ditë në vit, në periudhën një vjeçare të vlerësimit.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gjatë vitit 2019 ka marrë pjesë në cilësinë e ekspertes dhe lehtësueses, në 3 trajnime me tema të ndryshme, në fushën e të drejtës materiale dhe proceduriale penale, gjithësej 14 ditë.

²Rregullorja e Brendshme e Shkollës së Magjistraturës në pikën 9 të nenin 55 të saj, parashikon : “Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë: 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim; 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrjeje në trajnim; 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrjeje në trajnim.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet me 5 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se për periudhën e vlerësimit, për gjyqtaren nuk evidentohen të dhëna në lidhje me këtë tregues. Duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet me 3 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk evidentohet asnjë publikim ligjor i realizuar nga gjyqtarja gjatë vitit 2019.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli I vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	90	Shkëlqyeshëm

2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	95	Shkëlqyeshëm ³
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	378	Shumë mirë

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, Këshilli propozon dhe rekomandon që gjyqtarja {...} ;

1. të angazhohet në rritjen, edhe më shumë, të aftësive të saj organizative
2. të mbajë në konsideratë angazhimin e saj të vazhdueshëm në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.